



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.754/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Kadri Shalaku nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, Kadri Shalaku nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega në Kastriot, në fshatin Brezhticë, në Vendvotimin nr: 1503E/02D .

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017 në ora 15:45, nga Kadri Shalaku kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Kastriot të cilën pretendon se në fshatin Brezhticë, në vendvotimin (VV) nr.1503E/02D gjatë numërimit votat e tij i kanë bartur kandidatit të tret me nr.17 nga radhët e subjektit politik LDK. Më tutje thekson se nga provat e parashtruara në mënyrë bindëse rezulton se votat e tij në nr. 7 nga radhët e subjektit politik LDK i janë bartur kandidatit në nr. 17.

Në cilësi të provave si dëshmi ka përmendur votuesit Shemsije Krasniqi, Vlora Shalaku, Ilmi Pervetica, Kadri Krasniqi, Hajdar Krasniqi, Rexhep Krasniqi, Milaim Krasniqi, Ekrem Krasniqi dhe Jeton Krasniqi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet e parashtruara ne apel dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet e parashtruara ne apel janë të bazuara për faktin se paneli pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, konstatoj se në vendvotimin VV nr.1503E/02D gjatë numërimit të votave votat e apeluesit i janë bartur kandidatit të tret me nr.17 nga radhët e subjektit politik LDK, prandaj duke u bazuar ne nenin 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura si ne pjesën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultatet e dalura nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha me sipër ne mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr. 754/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.